



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME
INSPEKTORIATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PYJEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____._____.2025

Miratoi:
Kryeinspektor
Dallëndyshe BICI

PLAN PUNE PËR VITIN 2025

DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PYJEVE

Duke Vlerësuar:

Përmbushjen e përgjegjësiave institucionale që rrjedhin nga VKM nr. 893 e datë 04.11.2015 “Për Organizimin Dhe Funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit” si dhe nenet 34, 35 dhe 36 të Urdhrit nr. 424 e datë 25.11.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”.

Bazuar:

Në zbatim të nenit 3 pika ‘c’ e VKM nr. 893 e datë 04.11.2015 “Për Organizimin Dhe Funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit” si dhe nenet 22, 23, 24, 25 dhe 26 të Urdhrit nr. 424 e datë 25.11.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”,

Me qëllim:

Rritjen e parametrave të parandalimit të paligjshmërisë, forcimin e zbatimit të ligjit, rritjen e cilësisë së shërbimeve, rritjen e performancës dhe forcimin e integritetit të punonjësve të IKMT si qendrore dhe rajonale, rritjen e besimit dhe forcimin e marrëdhënieve me komunitetin, konsolidimi dhe forcimi i bashkëpunimit me qeverisjen vendore dhe institucionet e tjera.

Objekti:

1. Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve është institucioni qendror shtetëror përgjegjës në varësi të Ministrisë së Brendshme për kontrollin, mbrojtjen dhe sigurinë e fondit pyjor kullosor, Zonat e Mbrojtura, florën e faunën e egër, biodiversitetin, veprimtarinë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera.
2. Kontrollin, mbrojtjen e territorit dhe e peisazhit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e pyjeve.
3. Kontribuimi në hartimin e planeve të veprimit për mbrojtjen e pyjeve, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm duke drejtuar kryerjen e inspektimit, verifikimit dhe duke nxitur e bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në përmirësimin e zbatimit të ligjit në fusha përkatëse të veprimit që mbulon Drejtoria e Inspektimit në Pyje.
4. Rritja e parametrave të parandalimit të paligjshmërisë, forcimin e zbatimit të ligjit, rritjen e cilësisë së shërbimeve, rritjen e performancës dhe forcimin e integritetit të punonjësve të kësaj drejtorie, rritjen e besimit dhe forcimin e marrëdhënieve me komunitetin, konsolidimi dhe forcimi i bashkëpunimit

me qeverisjen vendore dhe institucionet e tjera.

5. Zbatimi i ligjshmërisë në fondin pyjor e kullosor, mbrojtja e pyjeve nga dëmtimet, prerjet, zëniet e përdorimet e paligjshme, zjarret, mbrojtjen e faunës së egër, zbatimin e moratoriumit në gjueti, pyje dhe bimëve medicinale e tanifere
6. Veprimtaria inspektuese dhe kontrolluese e pandërprerë për mbikqyrjen e territorit lidhur me fushen e pyjeve dhe parashikimin për të adresuar dhe parandaluar këto risqe.
7. Azhurnimi i legjislacionit dhe njohja me ndryshimet ligjore për trupën inspektuese.
8. Koordinim efikas dhe i shpejtë me të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë ligjzbatuese dhe institucione të tjera vendore për parandalimin e veprimtarive të kundraligjshme dhe kryerjen e të gjitha veprimeve ligjore dhe administrative
9. Përfaqësimi dhe pjesëmarrja në takime dhe tryeza për vazhdimësinë dhe koordinimin e legjislacionit në fuqi.

Për realizimin e prioriteve dhe objektivave, për Vitin 2025, nga Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve, do të ndërmerren masa dhe planifikohen këto detyra:

I.	SEKTORI I INSPEKTIMIT TË PYJEVE				
Nr.	Detyrat që do të kryhen	Afati	Do të kryhet nga	Do të kontrollohet nga	Komente
1.	Organizimi i punës dhe përshtatja e strukturës të Sektorit të Inspektimit Pyjor, sipas ligjit “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.	Gjatë vitit 2025	<u>Inspektorët</u> Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut Sektori i Inspektimit	Drejtori Roland Disha Drejtori Roland Disha	Forcimi i kapaciteteve institucionale nëpërmjet ristrukturimit dhe rritja e transparencës dhe efijensës gjatë inspektimeve në fondin pyjor publik, zonat e mbrojtura dhe në pyjet private, si dhe garantimi i zbatimit të parimeve dhe kërkesave të ligjit “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
2.	Përgatitja e udhëzimeve e rregullave për standartizimin e inspektimit të fondit pyjor, kullosor në funksion të parandalimit të prerjeve ilegale të pyjeve, zënies e përdorimit të paligjshëm të fondit pyjor e kullosor si dhe mbrojtjes së faunës së egër. Përgatitja e udhëzimit për analizën e riskut dhe marrja e masave për adresimin e problemeve sipas rëndësisë dhe shkallës së dëmtimeve.	Gjatë vitit 2025	<u>Inspektorët</u> Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut Sektori i Inspektimit	Drejtori Roland Disha	

3.	Përgatitja e udhëzimeve për përmirësimin e ekzekutimit të gjobave dhe ndjekjes së vjeljes së vlerës së dëmit të shkaktuar nga kundërvajtjet nga strukturat që administrojnë pyjet. Kontrolli i strukturave të administrimit të pyjeve për hartimin e planit vjetor të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota dhe ndjekja e zbatimit të tij.	Janar-Mars 2025	<u>Inspektorët</u> Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut Sektori i Inspektimit	Drejtori Roland Disha	Transferimi i shpejtë dhe mungesa e eksperiencës nga organet e Njesisë së Qeverisjes Vendore, ka shkaktuar një sërë problemesh që duhet të identifikohen dhe parandalohen në kohën e duhur. Bashkëpunimi dhe shkëmbim informacioni i vazhdueshëm me Njësitë e Qeverisjes Vendore.
4.	Kontrolli i strukturave të administrimit të pyjeve për masat për parandalimin, menaxhimin dhe fikjen e zjarreve në pyje dhe kullota.	Maj-Gusht 2025	<u>Inspektorët</u> Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut Sektori i Inspektimit	Drejtori Roland Disha	Parandalimi i dëmtimit të pyjeve në funksion të ruajtjes së mbulesës vegjetative dhe funksioneve ekologjike, ekonomike dhe sociale të pyjeve.
5.	Inspektim në subjektet që grumbullojnë, përpunojnë produktet pyjore, bimët mjekësore etero-vajore. Inspektime në rrugët auto-pyjore, nacionale për evidentimin e transportit të paligjshëm të materialeve drusorë dhe atyre me origjinë në fondin pyjor.	Shkurt 2025-Nëntor 2024	<u>Inspektorët</u> Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut Sektori i Inspektimit	Drejtori Roland Disha	Ulja e nivelit të prerjeve ilegale dhe ndëshkimi administrativ ose penal i kundërvajtësve. Kontrolli i zbatimit të ligjshmërisë sipas llojit të aktivitetit dhe detyrimeve që kanë.
6.	Grumbullimi, përpunimi dhe përgatitja e evidencave mujore, të kundravajtjeve në pyje, kullota, zjarreve në fondin pyjor e kullosor dhe atyre për ecurinë e hetimit të veprave penale.	Çdo muaj	<u>Inspektorët</u> Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut Sektori i Inspektimit	Drejtori Roland Disha	Të dhëna të përgjithshme identifikuese për kundërvajtjet në fondin pyjor.

7.	Krijimi i regjistrit kombëtar të gjobave/shkeljeve për kundërvajtjet në pyje, kullota e gjueti dhe rifreskimi i tij në vazhdimësi.	Çdo muaj	Elvis Kolaveri	Drejtori Roland Disha	Përditësimi i regjistrit me rubrikat përkatëse do të përmirësojë shkallën e analizës dhe klasifikimit të natyrës së kundërvajtjeve dhe zbatimit të procedurave për ecurinë e vjeljes së gjobave.
8.	Krijimi i regjistrit kombëtar të zënieve të paligjshme të fondit pyjor dhe ndjekja e praktikave shkresore e ndërhyrjeve në terren për çlirimin dhe prishjen e ndërtimeve.	Mars - Tetor 2025	<u>Inspektorët</u> Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut Sektori i Inspektimit	Drejtori Roland Disha	Përpunimi i të dhënave, përditësimi i regjistrit kombëtar të evidentimit të zënieve, përcjellja e praktikave për veprim në agjencitë e tjera shtetërore sipas fushave të veprimit.
9.	Bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, tatime, doganat dhe policinë e shtetit, për mbrojtjen e pasurive pyjore, në të gjitha nivelet	Gjatë vitit 2025	<u>Inspektorët</u> Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut Sektori i Inspektimit	Drejtori Roland Disha	Bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore.
10.	Inspektimi i zbatimit të legjislacionit rregullator për pyjet në administrim të Bashkive, AKZM –ve si dhe atyre privatë. Inspektim i subjekteve të shfrytëzimit të pyjeve për ndalimin e ushtrimit të paligjshëm të veprimtarisë së shfrytëzimit në fondin pyjor dhe disiplinimi i këtij aktiviteti (ushtrimi i inspektimeve periodike në drejtoritë rajonale të IKMT, sipas ngastrave të shfrytëzimit të kontraktuara me Bashkitë).	Gjatë vitit 2025	<u>Inspektorët</u> Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut Sektori i Inspektimit	Drejtori Roland Disha	

11.	Inspektim i aktivitet të gjuetisë në zbatim të moratoriumit për ndalimin e gjuetisë. Kontroll në strukturat e varësisë rajonale për mbrojtjen e pyjeve dhe aktiviteve që kryhen në fondin pyjor e kullosor në përputhje me ligjin si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tyre.	Janar-Mars 2025 Gusht-Tetor 2025	<u>Inspektorët</u> Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut Sektori i Inspektimit	Drejtori Roland Disha	
12.	Organizimi i trajnimeve me personelin e Inspektorët e Sektorit Pyjorë, pranë IKMT-ve rajonale, për zbatimin e legjislacionit rregullator për mbrojtjen e pyjeve, kullotave dhe faunës së egër e gjuetisë, Ligjin e Inspektimit etj.	Shkurt-Mars-Qershor 2025	<u>Inspektorët</u> Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut Sektori i Inspektimit	Drejtori Roland Disha	Njohja më e mirë e personelit të inspektimit të pyjeve me legjislacionin në fuqi. Hartimi i urdhërave dhe udhëzimeve për përmirësimin e punës. Shkëmbim informacioni.
13.	Organizimi i një udhëtimi studimor në një nga vendet e rajonit dhe të BE me ngjashmëri të strukturave të inspektimit në fushën e pyjeve e faunës së egër dhe mbrojtjen nga zjarret. Bashkëpunim dhe shkëmbim eksperience me shtetet fqinje për reformën institucionale në veçanti për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet e paligjshme dhe zjarret. Pjesëmarrja në aktivitet kombëtare dhe ndërkombëtare me objekt inspektimin dhe bashkëpunimin në fushën e inspektimit.	Nëntor 2025	<u>Inspektorët</u> Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut Sektori i Inspektimit	Drejtori Roland Disha	Hartimi i projektit; paraqitje e donatorëve, implementimi dhe mbajtja në efikasitet.
14.	Ndjekja e praktikave (kërkesa – ankesave) të ardhura e në vijim.	Gjatë vitit 2025	<u>Inspektorët</u> Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut Sektori i Inspektimit	Drejtori Roland Disha	Ecuria normale e punës së Drejtorisë së Inspektimit të Pyjeve. Krijimi i një database lidhur me evidencat hyrëse dhe dalëse.

II. PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË PUNËS DHE TEKNOLOGJISË					
Nr.	Detyrat që do të kryhen	Afati	Do të kryhet nga	Do të kontrollohet nga	Komente
1.	Pajisje me mjete të kalueshmërisë së lartë	Gjatë vitit	Inspektorët	Drejtori	Fuoristrade 4x4
2.	GPS	Gjatë vitit	Inspektorët	Drejtori	Matje sipërfaqesh
3.	Uniforma pune	Gjatë vitit	Inspektorët	Drejtori	Veshje verore dhe dimërore
4.	Pajisje zyre	Gjatë vitit	Inspektorët	Drejtori	Kompjuter, fotokopje
5.	Kancelari zyre	Gjatë vitit	Inspektorët	Drejtori	Stilolapsa, lapsa, dosje, A4, kapëse letrash
6.	Dron	Gjatë vitit	Inspektorët	Drejtori	Dylbi profesional
7.	Hypsometer	Gjatë vitit	Inspektorët	Drejtori	Nicon Forestry Pro II Për matjen e lartësisë së drurit
8.	Tryela Haglo	Gjatë vitit	Inspektorët	Drejtori	Matjen e moshës së drurit pa e dëmtuar atë.
9.	Kalibër matës	Gjatë vitit	Inspektorët	Drejtori	Për matjen e diametrit të drurit.
10.	Aparat fotografik	Gjatë vitit	Inspektorët	Drejtori	Cilësi profesionale

Plani Vjetor i Punës, ndërtohet mbi bazën e Analizës së Riskut. Duke qënë se risqet janë relative, mund të ndryshojnë në bazë të prioriteteve të institucionit, ndryshimit të strukturës apo detyrave funksionale të Drejtorisë, si dhe faktorëve të tjerë të jashtëm, mund të sjellë ndryshimin dhe përmirësimin e planit të hartuar.

Në çdo rast ndryshimi të këtyre komponentëve, Plani Vjetor i Punës do të azhurnohet me ndryshimet përkatëse, që do të pasqyrohen në Planet Mujore në vazhdim.

Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të Pyjeve

Roland DISHA

Faqja 8 nga 8